

BIBLIOTEKA
SHTETIT

DJH-1
V74

PIRRO VISARI


**Rrugët
nuk flenë**

vjersha

814-1
174.

PIRRO VISARI

Rrugët nuk flenë



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DITËN QË MBUSHA 20 VJET

Isha me shërbim ditën që mbusha 20 vjet
dhe në vend të 30 gotave të mbushura me verë,
dhe në vend të 30 urimeve të bujshme,
në karikatoren e automațikut,
rrinin të heshtur
30 fishekë.

Isha me shërbim ditën që mbusha 20 vjet,
e i pa gjumë ruaja gjumin e shokëve,
dhe oshëtinin hapat në natën e qetë,
dhe oshëtima sillte urimet e largëta
të nësës, vëllait, së dashurës:
— U bëfsh 100 vjet!

Atë natë të ngrirë si kristal,
unë mund të mbaja në qafë kitarën time,

e me të të sillja ndër mend,
vegimet e viteve që shkuan.

Megjithatë, ai qe më i bukurë përvjetor ditëlindjeje...

...Në qafë varej automatiku i rreptë
dhe kupa e qiellit pikonte yje mbi mua:
— Për shumë vjet gëzuar!

NË MUZEUMIN E MP BRËNDËSHME

*Në stendat e këtij muzeumi
ndodhet libri i një prifti
me një pistoletë mes fletëve.*

Pse çuditesh?
Kurdoherë pas mjegullës së frazave latine,
pas erës së këndshme të temjanit,
kurdoherë prapa ikonave e psallmeve
qafën çonin
tytat e armëve...

DUKE VËSHTRUAR TELAT E TENSIONIT TË LARTË NË VERI

Male dhe male!

Male që janë mësuar të mbajnë mbi shpatulla
gjithmonë diçka:
varre betejash, zana mbuluar me ferekhe,
kulla të vetmuara me kokën në re,
kushtime të thekshme me pëllëmbën tek veshi,
déborë të virgjër mbi krye si qeleshe.

Shtrihen tanë në shpatullat e tyre të mprehta,
telat e tensionit të lartë në qindra kilometra.

Dhe të ngjajnë tanë malet,
si ca çifteli vigane.
S'janë këngë tragjike mërmëritjet e tyre,

për krisma hakmarrjesh, daullesh me nerva.
Në këto tela
shoqërohet kënga e fuqishme e dritës,
e dritës në jetë,
e dritës në kulla,
e dritës në zemra...

VEZULLIME MBI METAL

Shiu rrjedh pareshtur nën xhaketë,
i ftohtë.

Shiu lag këmishën dhe kraharorin e nxehthë.

Nga larg, përmes mjegullës së tij,
vijnë vizionet e shtrenjta
rrudhat e nënës tek pragu i shtëpisë,
ku në secilën rri ulur një vit i fëmijnisë
profili i motrës përkulur mbi fletore.
Këto vizione më të buta se floku i borës,
më të ngrohta se ngrohtësia e dhomës.
Por, ashperohet shikimi,
tendoset fytyra,
përpara mjegullës së shiut
ndodhet
detyra...

...Shiu rrjedh pareshtur nën xhaketë,
mbi xhaketë metali shkëlqen ndër piklime.
Ndodhen larg
konturet e qytetit të lindjes.
Atje është një kitarë e magjishme,
(Me kitarë i kam përcjellë dikur vitet...)
një stol i bardhë nën muzgun ngjyrë jargavan
dhe një zemër që pret me mall.
Por ashpërsohet shikimi,
tendoset ftyra,
përmes shënjestrës së armës
duket
detyra...

KUR KTHEHESHIM PREJ PRITËS

*Nga kujtimet e një veterani të
organeve të sigurimit.*

Ktheheshim prej pritës.

Në rroba akoma baltë e ngjitur,
në rroba si qëndismë gjaku i piksur.

Qimet në mjekër
shponin si bizë.

Ktheheshim prej pritës
me fytet e gërvishura
nga dhëmbë banditësh.
Me javë dhe muaj
larg shtëpisë.

Dhe kur tek pragu
doçkat të hidhte djali,
një lot mund që s'mbahej
rridhte faqes tatëpjetë.